



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.



DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori Ekonomik “2 AT” shpk, me NIPT K14019001H, me seli në Adresën: Korçë – Dishnicë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës: REF-43122-01-31-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje karboni aktiv, për UKT sha”

Fondi Limit: 69,000,000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja: 9 muaj duke nisur nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme.

Data e zhvillimit të tenderit është: 12.03.2018 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.5 të dates 05/02/2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “2-MJ” shpk

L223190130

numri i NIPT-it

Vlera: 42.500.000 (dyzetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “T&M Chemical Distribution” shpk

L41823009V

numri i NIPT-it

Vlera: 42.250.000 (dyzetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” shpk

K22218003V

numri i NIPT-it

Vlera: 500.000 (gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik "POWER INDUSTRIES" shpk

K63029402A

numri i NIPT-it

Vlera: 64.750.000 (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik "2 AT" shpk

K14019001H

numri i NIPT-it

Vlera: 40.750.000 (dyzetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatoreve ekonomik "TRIMED" shpk & "INTERLOGISTIC" shpk

"TRIMED" shpk

K51612031J

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

"INTERLOGISTIC" sh.p.k

K216055003M

Emri i plotë i shoqërisë

numri i

NIPT-it

Vlera: 59.853.000 (pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë pa TVSH.

Jane skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "2-MJ" shpk.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria "2MJ" shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 9, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik "2-MJ" Sh.p.k s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 9, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "T&MCHEMICALS" shpk

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e

rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- ***Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit/ në pikën 2.3.2 si më poshtë cituar:***

Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me;

List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të app-së konstatoi se shoqëria ”T&M CHEMICALS ” shpk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri listëpagesat për periudhën Qershor 2017 –Dhjetor 2017 por **nuk ka arritur të paraqesë formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë.

- ***Së dyti AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:***

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të sëcilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, hedhjen ne silloz neper adresat e autorizuar nga AK (tek specifikimet teknike)

Nga shqyrtimi I dokumentacionit ne sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë deklaratën sipas kriterit të kërkuar në DT.

Në shtojcën 9 të DT parashikohet se ...**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ATLANTIK 3” sh.p.k

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- ***Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik në pikën 2.3.2 në pikën si më poshtë cituar:***

Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me;

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017.

List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar operatori ekonomik ka paraqitur në Sistemin Elektronik vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërore datë 27.02.2018 ku është specifikuar numri i punonjësve për secilin si dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar në DT.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk përmbush numrin mesatar prej 10 punonjësish të kërkuar në DT.

Nga verifikimi i listëpagesave dhe vërtetimi i paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” sh.p.k rezulton se numri mesatar për periudhën e kërkuar Qershor 2017-Dhjetor 2017 është 8.8 punonjës cka bie në kundërshtim me numrin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së dyti Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik në pikën 2.3.9 në pikën si më poshtë cituar:

9.Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si me poshtë:

1.Karbon Aktiv

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim.

Nga procesverbali i dorëzimit të mostrave të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ditën e zhvillimi të procedurës së prokurimit rezulton se operatori ekonomik ATLANTIK 3 sh.p.k nuk ka dorëzuar mostrat e këkuara pranë Autoritetit Kontraktor, në kundërshtim kjo me kushtet e kërkuara në DT.

Së treti Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik në pikën 2.3.8 në pikën si më poshtë cituar:

Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose qera një kamion me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton si dhe një autovinç me gjatësi të biges 25 metra me kapacitet ngrites mbi 500kg në lartësi 25m.

Per te vertetuar keto mjete duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Per mjetin autovinci kerkohet gjithashtu skeda teknike.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik “ATLANTIK 3”sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit në kundërshtim kjo me kriterin e kërkuar në DT.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga ana e Operatorit Ekonomik lidhur me mjetet , me pikën 2.3.8 është i paplotë , **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Së Katërti Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit/Kapaciteti teknik në pikën në pikën si më poshtë cituar:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, hedhjen ne silloz neper adresat e autorizuar nga AK (tek specifikimet teknike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ne sistemin elektronik K.V.O konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë deklaratën sipas kriterit të kërkuar në DT.

Në shtojcën 9 të DT parashikohet se ...**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “2 AT”shpk, me NIPT K14019001H, me administrator Z. Nuçi Shamija, me ofertë ekonomike me vlerë prej 40.750.000 (dyzetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH., se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.03.2018

Ankesa: Është paraqitur ankesë nga ana e OE “ATLANTIK 3” Sh.p.k me Nr. K-1645prot, më datë 05.04.2018, të cilës i është kthyer përgjigje nga ana e AK me anë të shkresës me Nr. K-1645/1 prot. më datë 06.04.2018, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Është paraqitur ankesë nga ana e OE “POWER INDUSTRIES” Sh.p.k me Nr. 10514 prot, më datë 05.04.2018, të cilës i është kthyer përgjigje nga ana e AK me anë të shkresës me Nr. 10514/1 prot. më datë 06.04.2018, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit kohor për ankimim në KPP, është paraqitur ankesa nga ana e e OE “POWER INDUSTRIES” Sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr. 387 datë 07.06.2018 vendosi: “*Të mos pranoj*

ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” Sh.p.k.”

Njoftimi i Rivlerësimit është bërë në datë 13.06.2018.

Brenda afateve ligjore që nga trajtimi i ankesave nuk ka patur ankesa pranë KPP.

